



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 181, Datë 06.07.2026

MBI

**PEZULLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN E
KËRKESËS SË SHOQËRISË “DRINI BULQIZË” SH.P.K. PËR TRANSFERIMIN E
PLOTË TË LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TE
SHOQËRIA “HEC POLEMI” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 66, pika 1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 14, pika 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1005/7 prot., datë 06.07.2026, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “DRINI BULQIZË” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 577, Seria P24, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 77, datë 29.04.2024, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 MW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës mbi tre degëzimet e Përroit të Neshtës, Degë e Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan, për një afat 30-vjeçar.
- Në vijim të aplikimit të shoqërisë, të depozituar në ERE me shkresën e protokolluar me nr. 1005 prot., datë 30.03.2026, si dhe dokumentacionit plotësues të administruar me shkresën nr. 1005/1 prot., datë 07.04.2026, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 117, datë 24.04.2026, vendosi fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria “DRINI BULQIZË” sh.p.k. te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k., si dhe fillimin e procedurës për dhënien e autorizimit për transferimin e aseteve fikse të centralit hidroelektrik “Polemi”.
- Për vendimin si më sipër, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 1005/4 prot., datë 07.05.2026, duke i kërkuar të bëjë me dije nëse ka një qëndrim ndryshe në lidhje me transferimin e licencës dhe aseteve të shoqërisë.
- Në përgjigje të kësaj kërkesë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1005/7 prot., datë 28.05.2026, bëri me dije se kërkesa e shoqërisë për miratimin e ristrukturimit organizativ/transferimit të aktivitetit ishte ende në proces shqyrtimi. Njëkohësisht, ministria evidentoi se, në përputhje me parashikimet e kontratës së

lidhur me mbajtësin e miratimit, për çdo transferim të aksioneve ose të kapitalit themeltar tek të tretët kërkohet pëlqimi paraprak i saj.

- Me qëllim sqarimin e natyrës së procedurës administrative të zhvilluar në ERE, kjo e fundit, me shkresën nr. 1005/9 prot., datë 04.06.2026, i kërkoi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të shprehej posaçërisht mbi kërkesën për transferimin e licencës dhe të aseteve, duke sqaruar se procedura objekt shqyrtimi nuk lidhej me ndryshimin e ortakëve të shoqërisë, por me transferimin e licencës dhe të aseteve të saj, ndërsa çdo qëndrim i ministrisë do të merrej në konsideratë gjatë vlerësimit përfundimtar të kërkesës.
- Paralelisht me korrespondencën institucionale, gjatë shqyrtimit të aplikimit u konstatua nevoja për plotësimin e dokumentacionit shtesë, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1005/10 prot., datë 04.06.2026, duke kërkuar administrimin e dokumentacionit shtesë të nevojshëm për vijimin e procedurës.
- Duke qenë se, nuk ishte administruar ende qëndrimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria rezultonte ende i paplotë, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 161, datë 05.06.2026, vendosi zgjatjen me 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimmarrjes për shqyrtimin e kërkesës për transferimin e licencës dhe për transferimin e aseteve të paluajtshme të HEC “Polemi”.
- Në vijim të kësaj procedure, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1005/11 prot., datë 10.06.2026, nr. 1005/12 prot., datë 11.06.2026, nr. 1005/14 prot., datë 25.06.2026, nr. 1005/15 prot., datë 26.06.2026 dhe e-mailin nr. 1005/16 prot., datë 29.06.2026, shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues.
- Nga dokumentacioni i administruar rezulton gjithashtu se shoqëria, me shkresën e saj nr. 08/6 prot., datë 08.06.2026, i është drejtuar Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, në kuadër të transferimit të të drejtave të shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.
- Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 934/1 prot., datë 12.06.2026, AMBU ka sqaruar shoqërinë se duhet të paraqesë aplikimin për transferimin e lejes për përdorim burimi ujor dhe të mbajë në konsideratë që të kryejë reflektimet përkatëse në kontratën e nënshkruar me MIE-n. Në vijim, me shkresën e datës 29.06.2026, shoqëria ka depozituar formularin e aplikimit për transferimin e lejes për përdorimin e burimit ujor të HEC “Polemit”, të nxjerrë nga sistemi e-leje dhe drejtuar AMBU.
- Nga verifikimi i dokumentacionit administrativ rezulton se, deri në datën e shqyrtimit të kësaj çështjeje nga bordi i ERE-s, nuk është administruar ende qëndrimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë lidhur me kërkesën e paraqitur nga shoqëria, ndërsa nuk ishte depozituar as Shtojca nr. 1, e kërkuar në kuadër të procedurës së transferimit të licencës.

Pezullimi i afatit të vendimmarrjes

- Në nenin 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: *nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.*

- Po ashtu, në nenin 14, pika 10, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar, parashikohet se bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në këtë procedurë rezulton se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka bërë me dije se kërkesa e shoqërisë për ristrukturimin organizativ/transferimin e aktivitetit vijon të jetë në shqyrtim. Po ashtu, ministria ka evidentuar se, sipas marrëdhënies kontraktore të krijuar ndërmjet palëve, për transferimin e aksioneve ose të kapitalit themeltar tek të tretët kërkohet pëlqimi paraprak i saj.
- Nga ana tjetër, rezulton se shoqëria ka filluar edhe procedurën administrative për transferimin e lejes për përdorimin e burimit ujor pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, procedurë e cila, në momentin e shqyrtimit të kësaj çështjeje nga Bordi, nuk rezulton të ketë përfunduar.
- Bordi vëren se procedura administrative e zhvilluar në ERE ka për objekt transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike dhe autorizimin për transferimin e aseteve të paluajtshme të të licencuarit, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij. Për rrjedhojë, vlerësimi mbi kërkesën për transferimin e licencës është kompetencë ekskluzive e Bordit të ERE-s dhe ushtrohet në mënyrë të pavarur, bazuar në kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga legjislacioni sektorial. Megjithatë, ushtrimi i kësaj kompetence kërkon që Bordi të disponojë një tablo të plotë të rrethanave faktike dhe juridike që lidhen me kërkesën objekt shqyrtimi. Në këtë kuadër, procedurat administrative që vijnë në zhvillim pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore përbëjnë elemente të rëndësishme të cilat, ndonëse nuk zëvendësojnë kompetencën vendimmarrëse të ERE-s, janë të nevojshme për administrimin e plotë të provave dhe për garantimin e një vendimmarrjeje të bazuar në të gjitha rrethanat përkatëse të çështjes.
- Po kështu, rezulton se deri në këtë fazë të procedurës nuk është administruar ende qëndrimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë mbi kërkesën e shoqërisë, si dhe nuk është plotësuar i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga ERE, konkretisht Shtojca nr. 1, e cila përbën pjesë të dokumentacionit të domosdoshëm për përfundimin e shqyrtimit administrativ.
- Në këto kushte, bordi çmon se, në zbatim të nenit 14, pika 10, të Rregullores së Licencimit, si dhe duke mbajtur në konsideratë parashikimet e nenit 66 të Kodit të Procedurave Administrative, ekzistojnë rrethana objektive që justifikojnë pezullimin e afatit të vendimmarrjes deri në administrimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe përfundimin e procedurave administrative që lidhen me kërkesën objekt shqyrtimi. Gjithashtu, duke qenë se neni 17, pika 5, i Rregullores së Licencimit parashikon se transferimi i licencës kryhet paralelisht me transferimin e aseteve fikse të të licencuarit, pezullimi i vendimmarrjes për transferimin e licencës sjell domosdoshmërisht edhe pezullimin e vendimmarrjes lidhur me dhënien e autorizimit për transferimin e aseteve të paluajtshme të HEC “Polemi”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pezullojë afatin e vendimmarrjes për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. për transferimin e licencës nr. 577, Seria P24, dhënë me vendimin e Bordit

të ERE-s nr. 77, datë 29.04.2024, për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 MW, te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k., deri në administrimin e qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe plotësimin e dokumentacionit të kërkuar në kuadër të kësaj procedure administrative.

2. Të pezullojë afatin e vendimmarrjes për shqyrtimin e kërkesës për dhënien e autorizimit për transferimin e aseteve të paluajtshme të HEC “Polemi”, nga shoqëria “DRINI BULQIZË” sh.p.k. te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k., deri në plotësimin e kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Shqyrtimi administrativ i kërkesës do të rifillojë pas administrimit të qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe plotësimit të dokumentacionit të kërkuar nga ERE, nëse ky dokumentacion rezulton ende i paplotë.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, ngarkohet me njoftimin e këtij vendimi shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k., si dhe palëve të përfshira në këtë procedurë me ndjekjen e mëtejshme të procedurës administrative deri në plotësimin e kushteve për vijimin e shqyrtimit të saj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir AHMETI